



HIDROCENTRALET NË KOSOVË PROBLEMET DHE POTENCIALI I TYRE REAL

MARS 2019

Hidrocentralet në Kosovë – Problemet dhe potenciali i tyre real

Data e publikimit: **Mars 2019**

© Të gjitha të drejtat janë të rezervuara nga Balkan Green Foundation dhe Instituti për Politika Zhvillimore (INDEP). Të drejtat e pronësisë intelektuale mbrohen nga Ligji për të Drejtat e Autorit dhe të drejtat e përafërta.

Asnjë pjesë e këtij publikimi nuk mund të riprodhohet, të ruhet në një sistem rikthimi ose të transmetohet në ndonjë formë ose përmes ndonjë mënyre, qoftë në mënyrë elektronike, mekanike ose në ndonjë mënyrë tjetër, pa lejen me shkrim të botuesit.

Përdorimi për qëllime komerciale i të gjitha raporteve të publikuara nga Balkan Green Foundation dhe Instituti për Politika Zhvillimore (INDEP) nuk lejohet pa pëlqimin me shkrim.

Ju lutemi kontaktoni: info@balkangreenfoundation.org ose numrin +383 (0) 49 728-019

Balkan Green Foundation (BGF) është iniciativë rajonale e themeluar për të avokuar dhe promovuar zhvillimin e qëndrueshëm në Ballkanin Perëndimor, duke u përqendruar veçanërisht në një numër temash të rëndësishme siç janë zhvillimi i qëndrueshëm ekonomik, mbrojtja e mjedisit, zhvillimi i energjisë dhe ndryshimet klimatike. BGF punon për t'i avancuar praktikatat e zhvillimit të qëndrueshëm si mënyra për të siguruar dhe maksimizuar mundësitë për të gjithë përmes avokimit të politikave dhe zhvillimit të projekteve në Kosovë dhe në rajon.

Instituti për Politika Zhvillimore (INDEP) është institut kërkimor dhe qendër e avokimit që ofron zgjidhje strategjike për politika publike, bazuar në hulumtime të pavarura. Themeluar më 2011 si një shoqatë e analistëve të politikave, hulumtuesve dhe aktivistëve të shoqërisë civile, INDEP fokusohet në politikatat zhvillimore, duke ofruar një vizion përmbajtësor për integrimet Euro-Atlantike. Në Kosovë, ku edhe vepron, INDEP ka në fokus të veçantë forcimin e qeverisjes demokratike dhe luan rolin e mbikëqyrësit të politikave publike.

Foto në ballinë: ZRRE dhe Organizata “Gjethi”.

PËRMBAJTJE

1. Përmbledhje.....	5
2. Hyrje – Situata e përgjithshme	6
3. Gjendja dhe rregullimi i sektorit të hidroenergjisë	7
3.1 Llojet e hidrocentraleve në Kosovë	8
3.2 Akterët dhe korniza ligjore.....	10
3.3 Planet dhe strategjitë për energjinë hidrike në Kosovë	11
3.4 Licencat e lëshuara/akterët monitorues dhe autorizimet për ndërtim të HC	13
3.5 Standardet dhe normat evropiane.....	14
4. Problemet e përgjithshme dhe ndikimet konkrete të hidrocentraleve të reja	15
4.1 Rast Studimi: Parku Kombëtar “Bjeshkët e Nemuna” – Kaskada e Lumbardhit	18
4.2 Rast Studimi: Parku Kombëtar “Sharri” – Kaskada e Lepencit.....	22
5. Përfundim.....	23
6. Rekomandime	25
7. Aneks	27
7.1 Hidrocentralet në vend.....	27
7.2 Institucionet dhe akterët që ndërlidhen për pajisje me leje për HC të ri.....	28

Shkurtesat

AMMK – Agjencioni për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës

ASK – Agjencia e Statistikave të Kosovës

BE – Bashkimi Evropian

BRE – Burime të Ripërtërithme të Energjisë

GZ – Gazeta Zyrtare

HC – Hydrocentral

HCV – Hydrocentral i vogël

KEDS – Kompania Kosovare e Distribuimit të Energjisë Elektrike

KEK – Korporata Energjetike e Kosovës

KOSTT – Operator i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut të energjisë Elektrike në Kosovë.

MMPH – Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor

MW – Megavat

MWh – Megavat orë

MZHE – Ministria e Zhvillimit Ekonomik

ZRRE – Zyra e Rregullatorit për Energji

1. Përmbledhje

Në Kosovë, në aspektin e politikbërjes dhe formulimit të strategjive, parashihet që të bëhet një shfrytëzim maksimal i resurseve natyrore për prodhim të energjisë elektrike në mënyrë që të përafrohen caqet prej 25% nga burimet e ripërtëritshme në kuadër të Komunitetit të Traktatit të Energjisë. Sipas Strategjisë së Energjisë për Kosovën, deri në vitin 2020 parashihet që të jenë të instaluara kapacitete gjeneruese prej 240 MW nga burimet hidrike.¹

Kosova nuk është vend me potencial të madh hidroenergjetik kryesisht për shkaqe gjeografike që ndërlidhen me aspektin topografik - relievi është kryesisht në trajtë të rrafshnaltës i karakterizuar me terren relativisht të butë dhe reshje të pakta shiu. Në rajonin e Ballkanit Perëndimor, Kosova është vendi me i varfër sa i përket burimeve ujore në dispozicion - 1,600 metër kub ujë për kokë banori.² Shqipëria ka në dispozicion rreth 13,000 metër kub ujë për kokë banori³, ndërsa Maqedonia e Veriut rreth 3,000.

Shumica e hidrocentraleve të vogla ekzistuese dhe ato të planifikuara gjenden në brendi të zonave me rëndësi të veçantë natyrore si parqe kombëtare, rezervate strikte të natyrës, zona të veçanta të mbrojtura, dhe zona me veçori të shumta relikte dhe endemike të florës, vegjetacionit, faunës, habitateve natyrore, bimore dhe shtazore. Kjo paraqet rrezik të madh që këto zona të dëmtohen përgjithmonë dhe të degradohen paisazhet natyrore e burimet ujore të vendit, sikurse në rastin e ndërtimeve të hidrocentraleve në Gryken e Deçanit.

Shqetësuese janë rastet e caktuara ku për t'u favorizuar projekte specifike formohet këshill ndërministror që ka fuqinë ekzekutive që të ndryshojë zona të caktuara prej Zonës 1 në Zonë 3. Në Zonën 3 lejohet ndërtimi i hidrocentraleve ndërsa në Zonën 1 dhe 2 kjo nuk është e mundur. Një mundësi e tillë e ndërrimit është e padrejtë dhe duhet të rregullohet në mënyrë ligjore. Kompetencë e tillë e përcaktimit të zonave dhe hartave zonale e zonimit duhet t'i takojë ekskluzivisht ekspertëve dhe të mos ketë politizim e ndikime politike në të e aq më tepër nuk duhet asesi të lejohet ndërtimi i hidrocentraleve në parqe kombëtare.

Ky dokument ka për qëllim të analizojë situatën e përgjithshme të sektorit të hidroenergjisë në Kosovë, potencialin real të këtyre projekteve, ndikimet, dhe problemet kryesore. Në pika të shkurtra përmenden hidrocentralet ekzistuese në vend, ato që planifikohen të ndërtohen, problemet dhe ndikimi real i këtyre hidrocentraleve në mjedis si dhe shqetësimet që ndërlidhen me këto ndërtime nga komunitetet lokale.

Ky hulumtim konstaton se hidrocentralet kanë kryesisht probleme dhe ndikime negative për shkaqe (1) sociale [konflikte shoqërore dhe protesta], (2) politike [konflikte interesi, shtrembërim i vullnetit politik, subvencionimi i hidrocentraleve], (3) ekonomike [ujitja dhe uji i pijes, turizmi, balanci energjetik, dhe

¹ Ministria e Zhvillimit Ekonomik (2017). *Strategjia e Energjisë 2017-2026*. Marrë nga: https://mzhe-ks.net/repository/docs/Strategjia_e_energjiise_2017-26_-_.pdf

² MMPH - AMMK (2015). *Raport për Gjendjen e Ujërave në Republikën e Kosovës*. Marrë nga: [http://ammk-rks.net/repository/docs/Raporti_i_ujrave_i_2015_shqip_\(2\).pdf](http://ammk-rks.net/repository/docs/Raporti_i_ujrave_i_2015_shqip_(2).pdf)

³ Pasuritë Ujore Shqiptare, marrë nga: http://37.139.119.36:81/publikime_shkencore/ALB-RIVERS-WEB-PDF/009-28-Kreu1-Ujjerat-Shqiptare.pdf

degradimi i tokave bujqësore], dhe (4) mjedisore [shkatërrimi dhe modifikimi i habitateve natyrore, eriozioni i tokës, dëmtimi i pyjeve dhe natyrës, tharja e lumenjëve, ndotja e ujit për shkak të punimeve, dhe ndotjea e mjedisit gjatë mirëmbajtjes].

2. Hyrje – Situata e përgjithshme

Sipas Strategjisë së Energjisë 2017-2026, hidrocentralet zëjnë një pjesë të konsiderueshme të energjisë nga BRE-të. Shumica e hidrocentraleve që planifikohen të ndërtohen në Kosovë bien kryesisht në zona të veçanta natyrore e të mbrojtura ku potenciali hidrik është më i madh. Realizimi i këtyre projekteve mund të shkaktojë probleme të shumta mjedisore me dëmtime të imazhit natyror si dhe ndikime negative në florë dhe faunë, të cilat veçse janë të rrezikuara. Probleme të mëdha këto projekte mund të kenë edhe në relacion me ndryshimet e rrjedhës së lumit, tharjes së tyre, erozionit, shpyllëzimit, kontaminimit të ujit me vajra e mjete inerte, dëmtim të turizmit, zhdukjes së lumenjëve e përrojeve nëpër tuba me kilometra të tëra dhe mos respektimi i minimumit biologjik i cili është përcaktuar në rreth 30% të rrjedhës normale të ujit, sidomos gjatë stinës së verës.

Kosova është anëtare e Traktatit të Komunitetit të Energjisë dhe rrjedhimisht ka obligime dhe detyrime që duhet t'i plotësojë dhe zbatojë. Kosova ka obligim që 25% të burimeve të energjisë ti ketë nga burimet e ripërtëritshme të energjisë (BRE) deri në vitin 2020. Me Udhëzim Administrativ për caqet e BRE nr.01/2003, është vendosur caku ambicioz prej 29%.⁴ Ky plan është me të vërtetë ambicioz dhe i pamundur që të arrihet. Vlerësohet se deri më tani pjesëmarrja e BRE-ve është shumë nën atë nivel (ASK konsideron se është nën 15% të totalit të energjisë së shfrytëzuar në vend, këtu përfshihen si burim i ripërtëritshëm edhe druri për ngrohje apo biomasa (shih figurën 1).

Vlera prej 25% të BRE-ve në pjesëmarrjen totale të energjisë i detyrueshëm nga Traktati i Komunitetit të Energjisë është realisht e paarrtshme. Si shkak, Raporti i Progresit për Kosovën (2018) nga Komisioni Evropian përmend kryesisht vonesat burokratike dhe pajisjet me licenca të ndryshme si mungesë e një mekanizmi efektiv burokratik/administrativ. Ky raport gjithashtu përmend edhe mungesën e progresit në mbrojtjen e mjedisit në përgjithësi, por edhe në atë të ujërave.⁵ Për t'i arritur këto zotime të tyre qoftë edhe në letër (25-29% të BRE-ve deri me 2020), autoritetet e Kosovës kanë vendosur që të bëjnë lejimin e ndërtimeve të kapaciteteve të reja ujore në çdo cep të vendit. Në kuadër të caktit 25% prej BRE-ve, parashikohet që prioritet të jenë hidrocentralet (240 MW), pastaj energjia e erës (150 MW), energjia solare (10 MW), dhe biomasa/biogazi (14 MW). Vlenë të përmendet se Kosova ka potencial të konsiderueshëm diellor me një mesatare prej 278 ditësh me diell dhe 2000 orë diell në vit.

Është pozitiv vendimi i Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH) për të vazhduar me moratorium të përgjithshëm për ndërtimin e hidrocentraleve të reja në vend, pa u bërë një analizë e

⁴ MZHE (2013), *Plani Kombëtar i Veprimet për Burimet e Ripërtëritshme të Energjisë (PKVBRE) 2011-2020*. Marrë nga: [http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/PLANI_KOMBETAR_I_VEPRIMIT_PER_BURIMET_E_RIPERTERITSHME_TE_ENERGJISE_\(PKVBRE\)_2011-2020.pdf](http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/PLANI_KOMBETAR_I_VEPRIMIT_PER_BURIMET_E_RIPERTERITSHME_TE_ENERGJISE_(PKVBRE)_2011-2020.pdf)

⁵ Komisioni Evropian (2018), *Raporti i vitit 2017 për Kosovën*. Marrë nga: http://www.mei-ks.net/repository/docs/kosovo_report_2018_shqip.pdf

mirëfilltë e kapaciteteve ujore që posedon Kosova. Kjo gjë ka rezultuar edhe me zero aplikime në ZRRE për t'u pajisur me autorizime preliminare për hidrocentrale të reja. Po ashtu MZHE ka bërë alokimin e kapaciteteve të rezervuara nga hidro në erë, pikërisht për shkak të problemeve mjedisore e sociale që këto impiante ngërthejnë.

3. Gjendja dhe regullimi i sektorit të hidroenergjisë

Sipas KOSTT, Kosova ka në total 95.7 MW energji hidrike të instaluar si në rrjetin e transmisionit dhe atë të distribucionit.⁶ Prej këtyre priten që tani të shtohen edhe 20 hidrocentrale të vogla (HCV) me gjithsej 78.8 MW të reja. Pjesa dërmuese e këtyre ndërtimeve janë planifikuar të vendosen në parqe kombëtare, apo fare pranë tyre kryesisht në Bjeshkët e Sharrit (shih figurën 1 në faqen tjetër).⁷ Nëse realizohen këto projekte, Kosova do t'i ketë 174.5 MW kapacitet të instaluar me energji hidrike.

Projekti i vjetër i HC Zhur me 295 MW fuqi të instaluar, në strategjitë dhe planet e ndryshme që ka përpiluar Ministria e Zhvillimit Ekonomik është kontraproduktiv dhe jep imazhin e fryrë sikurse Kosova ka potencial të madh hidrik, ndërsa ky hidrocentral do të funksiononte vetëm gjatë orëve të pikut (peak) me nga 4-6 orë dhe ngërthen në vete probleme ndërkombëtare sepse ndikon në ndryshimin e rrjedhës së lumenjëve. Në aspektin e fizibilitetit, kthimi i investimit do të zgjaste rreth 50 vite dhe do të humbeshin rreth 3 kilovat energji gjatë tarifës së ulët për një kilovat energji të fituar gjatë orës së pikut (tarifës së lartë).⁸

Balkan Green Foundation ka kërkuar që të largohet projekti i vjetër i HC Zhur nga të gjitha planet sepse ai projekt përpos që ka probleme të mëdha në vetvete, si për nga fizibiliteti ekonomik dhe arsyeshmëria politike, ka edhe pasoja të mëdha ambientale dhe sasia e prodhuar nga ai nuk e arsyeton investimin. Shqetësuese mbetet edhe licencimi dhe autorizimet për ndërtim të kapaciteteve të reja ku investitorët i shohin këto si afarizëm të thjeshtë dhe nuk i konsiderojnë modalitetet tjera sikurse është mjedisi, interesat e komunitetit, biodiversiteti etj.

Kosova mund të përfshihet si aksionare në një investim në hidrocentralin e Skavicës në Shqipëri i cili pritet të ketë 200 MW të instaluar që do të kenë rol balancues për sistemin elektro-energjetik të Kosovës dhe të Shqipërisë, projekt ky i cili mund të bashkfinancohet edhe nga Bashkimi Evropian.⁹

Balkan Green Foundation konsideron se shfrytëzimi i pa planifikuar dhe pa kontrollë i rezervave hidrike është i dëmshëm për mjedisin dhe shoqërinë, krijon pasoja afatgjate dhe nuk është i qëndrueshëm për shkak se nuk ka përmbajtje të standardeve ndërkombëtare, kritereve për mbrotjen e rrjedhës së

⁶ KOSTT (2018), *Kapacitet e Instaluar të Energjisë Elektrike në Kosovë*. Marrë nga: http://www.kostt.com/website/index.php?option=com_content&view=article&id=841&lang=sq

⁷ ZRRE (2018), *Regjistri i Aplikuesve për Autorizim*. Marrë nga: http://ero-ks.org/2018/Autorizimet_Licencat/12_11%202018%20Regjistri%20i%20Aplikuesve%20p%C3%ABr%20Autorizim%20dhe%20Pranim%20ne%20Skemen%20Mbeshtetese.pdf

⁸ MZHE (2008), *Rishikimi i Studimit të Fizibilitetit për HC Zhur*. Marrë nga: https://mzhe-ks.net/repository/docs/hpp_zhur_part5_summary_Shqip.pdf

⁹ Ekonomia (2018), *Lluka dhe Minxhozi bisedojnë për Hidrocentralin Skavica*. Marrë nga: <http://www.ekonomia-ks.com/sq/energjetike/lluka-dhe-minxhozi-bisedojne-per-hidrocentralin-skavica>

lumenjëve e si pasojë shkakton dëmtim të faunës, florës dhe ngërthen në vete impakte negative në jetën e komuniteteve lokale. Mungon poashtu edhe respektimi i kritereve për mbrojtje të parqeve kombëtare dhe zonave të tjera me interes të veçantë nga ndërhyrjet afatgjate.

3.1 Llojet e hidrocentraleve në Kosovë

Hidrocentralet ekzistuese në Kosovë janë kryesisht hidrocentrale pa liqene akumuluese dhe pa rezervuare të mëdha, me përjashtim të HC Ujmanit. Shumica dërmuese janë të llojit të hidrocentraleve të vogla që shfrytëzojnë rrjedhën e ujit dhe përdorin tubacione të gjata. Shumica e hidrocentraleve, për shkak edhe të terrenit të përthyer dhe potencialit më të madh të rënies gjenden kryesisht në vende malore dhe shtrihen në parqe kombëtare si ai i Sharrit dhe Bjeshkëve të Nemuna.

Gjenerimi i energjisë hidrike bëhet nëpërmjet rënjes së ujit (shndërrimit të energjisë potenciale) në energji (kinetike-lëvizëse) mekanike e cila arrihet nëpërmjet turbinave, të cilat më pastaj vënë në lëvizje gjeneratorët brenda objekteve që quhen hidrocentrale ku janë të vendosura edhe hapësirat e kontrollimit të ecurisë së punës - transformatorë, etj.¹⁰


Kosova nuk është vend me potencial të madh hidroenergjetik kryesisht për shkaqe gjeografike që ndërlidhen me aspektin topografik - relievi është kryesisht në trajtë të rrafshnaltës i karakterizuar me terren relativisht të butë. Faktor tjetër me rëndësi është pozita gjeografike ku vendi ynë shtrihet në distancë nga deti e në mes e ndajnë Alpet Shqiptare të cilat ja marrin shumicën e lagështisë masave të ajrit me rreshje që vijnë nga deti. Këto kushte hidrike, gjeologjike e pozita gjeografike bën që vendi ynë në tërësi të ketë potencial të ulët hidrik. Kosova është vendburim i lumenjëve si Drini i Bardhë, Sitnica, Lepenci dhe si e tillë paraqet bazë të ulët të rrjedhës së ujit. Vetëm lumi Ibër është ai i cili buron në Mal të Zi dhe kalon nëpër Kosovë, dhe pikërisht ky lum mban edhe hidrocentralin më të madh të vendit.

Llogaritet se për kokë banori brenda një viti janë në dispozicion 1,600 metër kub ujë, apo rrjedhë totale 121.2 metër kub në sekond.¹¹ Nëse krahasohet me Shqipërinë (që është ndër vendet më të pasura me ujë), Shqipëria ka 13,000 metër kub ujë. Nëse shikohet në rajon me vende sikurse Maqedonia e Veriut, Kosova rapë ka nivele të ulëta të ujit për metër kub - Maqedonia e Veriut ka rreth 3,000 metër kub ujë.

¹⁰ Energy.gov (2019). *How Hydropower Works*. Marrë nga: <https://www.energy.gov/eere/water/how-hydropower-works>

¹¹ Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor - AMMK (2015). *Raport për Gjendjen e Ujërave në Republikën e Kosovës*. Marrë nga: [http://ammk-rks.net/repository/docs/Raporti_i_ujrave_i_2015_shqip_\(2\).pdf](http://ammk-rks.net/repository/docs/Raporti_i_ujrave_i_2015_shqip_(2).pdf)

Figura 1. Hidrocentralet brenda parqeve kombëtare dhe zonave të tjera me rëndësi të veçantë natyrore.¹²



Tani në Kosovë sipas KOSTT janë 13 hidrocentrale me kapacitet të instaluar prej 95.7 MW ku niveli i prodhimit të tyre zakonisht është rreth 33%.¹³ Hidrocentralet kryesore të vendit janë: Ujmani (35 MW), Lumbardhi 1 (8 MW) dhe Lumbardhi 2 (7 MW), HC Deçani (9.5 MW), HC Belaja (7.5 MW), HC Brodi 1 & 2 (4.7 MW + 1MW), HC Albaniku 2 (4 MW), HC Restelica 1 & 2 (2.4 MW), HC Dikanci (3 MW), etj.¹⁴ Radavci është njëri nga hidrocentralet më të vjetra në vend i ndërtuar në vitin 1934 dhe është ende funksional. Gjatë renovimit të këtij hidrocentrali është ngritur fuqia gjeneruese nga 0.35 MW në 0.8 MW.¹⁵ Nje eficiency e tillë mund të arrihet potencialisht edhe në hidrocentralet tjera ekzistuese përmes përmirësimit të teknologjisë së tyre, ngase një pjesë e madhe e tyre ende përdorin teknologji të vjetëruar.

Sikurse shihet edhe në ilustrimin e më poshtëm, Kosova mbulon një sasi minimale të nevojave të saj energjetike nga burimet hidrike. Sipas të dhënave nga ASK, vetëm 1% e burimeve të përgjithshme të energjisë së përdorur vijnë nga energjia hidrike.

¹² Riverwatch (2018), *Balkan Rivers Map*. Marrë nga: <http://riverwatch.eu/en/balkanrivers/map>


¹³ ZRRE (2017), *Bilanci Vjetor i Energjisë Elektrike dhe Termike për Vitin 2017*. Marrë nga <http://ero-ks.org/2017/Sektoret/Bilanci%20Vjetor%20i%20Energjis%20Elektrike%20dhe%20Termike%20p%C3%ABr%20vitin%202017.pdf>

33% është numë r q ë ka rezultuar nga llogaritja e kapacitetit të instaluar në raport me prodhimin total.

¹⁴ KOSTT (2018), *Kapacitetet e Instaluar të Energjisë Elektrike në Kosovë. (Kapaciteti i Njësive të Gjenerimit, Sektori i Planifikimit Afatmesëm, fq. 2)*. Marrë nga: http://www.kostt.com/website/index.php?option=com_content&view=article&id=1001&Itemid=555&lang=sq

¹⁵ Ministria e Zhvillimit Ekonomik (2017), *Strategjia e Energjisë 2017-2026*. Marrë nga: https://mzhe-ks.net/repository/docs/Strategjia_e_energjisë_2017-26_-_.pdf

Figura 2. Pjesëmarrja e burimeve primare të energjisë – 2017.¹⁶



3.2 Akterët dhe korniza ligjore

Akterët kryesor institucional që ndërlidhen me punën e hidrocentraleve (por edhe BRE-të tjera) janë: Ministria e Zhvillimit Ekonomik (MZHE), Zyra e Rregullatorit të Energjisë (ZRRE), Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH), Agjencioni Pyjor i Kosovës, KOSTT, KEDS, Korporata Elektroenergjetike e Kosovës (KEK), dhe Komunitat (të cilat janë përgjegjëse për rregullimin e trekëndëshit institucion – biznes – qytetar). Për më tepër, shihni [Aneksin 7.2](#) ku janë të listuara institucionet dhe akterët që ndërlidhen me procesin e pajisjes me leje për HC të ri.

Kosova ka kornizë ligjore të zhvilluar në rregullimin e fushëveprimit të gjenerimit të energjisë elektrike dhe ujërave. Energjia hidrike (pjesë e BRE-ve) rregullohet me këto ligje dhe udhëzime administrative: Ligji Nr.05 / L – 081 për Energjinë; Ligji Nr.05 / L – 084 për Rregullatorin e Energjisë; Ligji Nr.05/L – 085 për Energjinë Elektrike; Ligji Nr.04/L – 016 për Eficiencën e Energjisë, si dhe këto ligje përcjellëse:

- Ligji Nr. 04/L-147 për Ujërat e Kosovës (GZ/Nr.10/29 Prill 2013).
- Ligji Nr. 04/L-144 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës (GZ Nr. 35/17 Dhjetor 2012).
- Ligji Nr. 04/L-110 për Ndërtim (GZ/Nr.18/03 Korrik 2013).
- Ligji Nr. 03/L-214 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis (GZ/Nr. 83/29 Tetor 2010).
- Ligji Nr. 03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit (GZ/Nr.06 Prill 2009).
- Ligji Nr. 04/L-060 për Mbeturina (GZ/Nr.17/29 Qershor 2012).
- Ligji Nr. 2004/29 për Pyjet e Kosovës (GZ/Nr.34; 01 Gusht 2008).
- Ligji Nr. 03/L-043 për Parandalimin dhe Kontrollin e Integruar të Ndotjes dhe Aneksit (GZ/Nr. 52 08 Maj 2009).
- Udhëzimi Administrativ Nr. 7/2017 mbi Lejet Mjedisore.

¹⁶ Agjencia e Statistikave të Kosovës (2018). *Balanca Vjetore e Energjisë në Republikën e Kosovës 2017*. Marrë nga <http://ask.rks-gov.net/media/4142/balanca-e-energjis%C3%AB-2017.pdf>

- Udhëzimi Administrativ Nr.01/2017 për Lëshimin e Lejeve Mjedisore Komunale.
- Draft-Udhëzimi Administrativ në krijimin e mekanizmave “one stop shop” për burimet e ripërtëritshme të energjisë Nr. 09/2017.
- Udhëzimi Administrativ Nr. 06/2017 për Promovimin e Shfrytëzimit të Energjisë nga Burimet e Ripërtëritshme. (I cili nuk parashihet masa teknike të efikasitetit në gjenerim për hidrocentrale, ndonëse për burimet tjera të BRE-së kërkohen ato masa.¹⁷)
- Udhëzimi Administrativ Nr. 05/2017 për Caqet e Energjisë nga Burimet e Ripërtëritshme.

3.3 Planet dhe strategjitë për energjinë hidrike në Kosovë

Baza strategjike dhe planet e veprimit në raport me hidrocentralet parashohin që të bëhet një shfrytëzim maksimal i resurseve natyrore për prodhim të energjisë elektrike në mënyrë që të përafrohen caqet në kuadër të Komunitetit të Traktatit të Energjisë prej 25% nga burimet e ripërtëritshme. Sipas Strategjisë së Energjisë, deri në vitin 2020 parashihet që në Kosovë të jenë të instaluar kapacitete gjeneruese prej 240 MW nga burimet hidrike. Këto plane dhe strategji nuk përkojnë me realitetin në teren dhe dëmet që vijnë nga këto impiante kanë ndikuar që shumë prej këtyre projekteve edhe të dështojnë. Sidomos pasi që shumë institucione komunale po i kundërshtojnë këto ndërtime dhe nuk po shohin përfitime konkrete për qytetarët e tyre nga to.

Strategjia e Energjisë për vitin 2017-2026 parashihet që hidrocentralet të jenë një komponentë e rëndësishme e BRE-ve në të ardhmën afat-mesme energjetike të Kosovës.¹⁸ Kosova ka edhe Strategjinë Shtetërore të Ujërave 2015-2034 që shërben si masterplan i zhvillimit dhe menaxhimit të resurseve ujore nga MMPH, ku parashihet mbrojtja dhe shfrytëzimi racional i këtyre resurseve.¹⁹ Fatkeqësisht, Strategjia e Energjisë si dhe vendimi i MZHE-së për të lejuar një numër kaq të madh të hidrocentraleve do të ndikojë negativisht në resurset ujore, në fakt kjo do të bëjë që të jemi një ndër vendet me shkallën më të lartë të shfrytëzimit të ujërave në rajon.

¹⁷MZHE (2017) *UA Nr.06/2017*. Marrë nga: [http://mzhe-ks.net/repository/docs/U_A_\(MZHE\)_NR_062017_PROMOVIMIN_E_SHFRYT%20T%20ENERGJIS%20NGA_BURIMET_E_RIP%20%20BRITSHME.pdf](http://mzhe-ks.net/repository/docs/U_A_(MZHE)_NR_062017_PROMOVIMIN_E_SHFRYT%20T%20ENERGJIS%20NGA_BURIMET_E_RIP%20%20BRITSHME.pdf)

¹⁸ Ministria e Zhvillimit Ekonomik (2016). *Strategjia e Energjisë 2017-2026*. Marrë nga https://mzhe-ks.net/repository/docs/Strategjia_e_energjisë_2017-26_.pdf

¹⁹ Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (2016). *Plani i Veprimit për Strategjinë për Ndryshime Klimatike*. Marrë nga: http://mmp-hks.org/repository/docs/Plani_i_Veprimit_per_Strategjine_per_Ndryshime_Klimatike_575795_301792.pdf

Tabela 1. Potenciali teknik i hidrocentraleve në vendet e Ballkanit Perëndimor – 2016.²⁰

Vendi	Potenciali total teknik (TTP)	Potenciali teknik i shfrytëzuar (UTP)		Potenciali teknik shtesë (ATP)	Pjesëmarrja në ATP
	(GWh)	(GWh)	(%)	(GWh)	(%)
Shqipëria	10.273	5.940	58	4.333	10
Bosnja dhe Hercegovina	24.351	6.535	27	17.816	39
Maqedonia e Veriut	9.786	1.443	15	8.343	18
Kosova	423	203	48	220	1
Mali i Zi	6.648	2.000	30	4.648	10
Serbia	20.489	10.507	51	9.982	22
Totali	71,971	26,629	37	45,342	100

Tabela 1 tregon potencialin teknik të shfrytëzuar (UTP), potencialin teknik shtesë (të mbetur) (ATP) dhe potencialin total teknik (TTP) sipas vendit. Potenciali teknik i hidrocentraleve përcaktohet si energjia vjetore që mund të zhvillohet sipas teknologjisë aktuale, pavarësisht nga kufizimet ekonomike dhe të tjera. Deri në fund të vitit 2016 Kosova kishte shfrytëzuar 48% të potencialit teknik të hidrocentraleve, duke u renditur kështu në vendin e tretë pas Shqipërisë dhe Serbisë. Sipas Bankës Botërore, "Kosova është e pakët me ujë, shumë më pak se të gjithë fqinjët e saj, dhe gjithashtu ka në mesin e tyre nivelin më të ulët të zhvillimit dhe ruajtjes së burimeve ujore. Kjo e bën Kosovën shumë të prekshme ndaj goditjeve klimatike."²¹

Duke konsideruar se në vendin tonë resurset ujore janë të mbishfrytëzuara, shtimi i hidrocentraleve do të rrisë edhe më shumë shfrytëzimin e tyre dhe do të mund të ndikojë edhe më tepër qëndrueshmërinë e posedimit të ujit për pije, për ujitje, apo edhe për nevoja të tjera. Ish-ministrja e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Albena Reshitaj, kishte premtuar se do të pezullojë lejet e mëtejshme të ndërtimit pasi që vlerësimi më i fundit i ujërave nëntokësorë ishte kryer në vitin 1984 dhe po këto rezultate nga ky vlerësim janë përdorur për të autorizuar ndërtimin e hidrocentraleve deri më sot.²²

Tabela 2. Caqet indikative për BRE-të deri më 2020 (të shprehura në MW).²³

	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020
Energjia fotovoltaike		3	4	6	7	8	9	10
Era	1.35	31.35	70	90	110	130	140	150
Hidrocentrale të vogla të reja		60	140	150	160	180	200	240
Biomasa		2	4	6	8	10	12	14
Total	1.35	96.35	218	252	285	328	361	414

²⁰ Western Balkans Investment Framework (2017). *Regional Strategy for Sustainable Hydropower in the Western Balkans (Final Report: Draft V3)*. Marrë nga <https://www.wbif.eu/content/stream/Sites/website/library/WBEC-REG-ENE-01-Final-Report-05.12a.pdf>

²¹ World Bank (2018). *Kosovo Water Security Outlook Report*. Marrë nga: <http://pubdocs.worldbank.org/en/496071548849630510/Kosovo-Water-Security-Outlook-Report.pdf>

²² Prishtina Insight (2018). *The fight for Kosovo's vanishing rivers*. Marrë nga <https://prishtinainsight.com/the-fight-for-kosovos-vanishing-rivers-mag>

²³ ZRRE (2016). *Vendim - Tarifat nxitëse*. Marrë nga: http://ero-ks.org/2016/Vendimet/V_810_2016.pdf

Plani kryesor që rregullon fushëveprimin e hidrocentraleve është Plani Kombëtar i Veprimit për Burimet e Ripërtëritshme të Energjisë 2011-2020 (PKVBRE), në draft-plan (i rishikuar).²⁴ Tabela 2 shpjegon planet e MZHE-së për kapacitetet e BRE-ve deri më 2020. Në këtë tabelë shihet se rëndësi primare do t'i kushtohet HCV-ve në krahasim me burimet tjera të BRE-ve. Plani i Kosovës dhe baza e saj strategjike për ndërtim të hidrocentraleve të reja të vogla është ambicioze dhe streson shumë gjendjen e përgjithshme të ujërave në Kosovë.

3.4 Licencat e lëshuara/akterët monitorues dhe autorizimet për ndërtim të HC

Akter kryesor në vend për lëshimin e licencave dhe autorizimeve është Zyra e Rregullatorit për Energji.²⁵ Të gjithë ata që janë të interesuar në prodhim të kapaciteteve të reja gjeneruese, qoftë edhe për nevoja vetanake, janë të obliguar që të aplikojnë/njoftojnë ZRRE-në për një iniciativë të tillë. ZRRE si autoritet rregullativ ka edhe kompetencën e monitorimit e të zbatimit të marrëveshjeve për ndërtim të kapaciteteve të reja dhe periodikisht bën vizita në terren për të monitoruar ecurinë e proceseve/investimeve.

Tabela 3. Përmbledhje e autorizimeve për ndërtim/operim dhe pranimi në skemën mbështetëse (feed-in tariffs).²⁶

	Nr. i Aplikacioneve	Kapaciteti (MW)
Autorizime finale në operim	6	31.3
Autorizime finale	19	75.5
Autorizime preliminare	0	0
Aplikacione në proces	1	3.3
Totali ²⁷	26	110

Sikurse shihet në tabelën mësipërme, deri më tani në aplikacione të reja për hidrocentrale kanë autorizim final rreth 31.3 MW apo 6 kapacitete që janë në prodhim. Autorizime finale të cilat së shpejti pritet të hyjnë në funksion janë 75.5 MW, autorizime preliminare dhe në proces është gjithsej 1 kapacitet me prodhim të përgjithshëm prej 3.3 MW. Pas finalizimit të këtyre autorizimeve, Kosova do t'i ketë shtesë edhe 124 MW energji hidrike me rreth 50% kapacitet të operimit gjatë variacioneve verë-dimër.

Tarifat nxitëse (feed-in tariffs): Një nga faktorët kryesorë që ka nxitur investimin në energji hidrike është disponueshmëria e tarifave nxitëse (feed-in tariffs) të cilat i ofrojnë dhe garantojnë investitorëve kthim dhe fitim të sigurtë deri në 12 vite. Qëllimi i kësaj politike është nxitja e zhvillimit të energjisë së ripërtëritshme edhe pse historikisht Kosova ka mbështetur më shumë projekte hidroenergjiike sesa nga

²⁴ Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës (2017). *Udhëzimi Administrativ (MZHE) Nr. 05/2017: Caqet e Energjisë nga Burimet e Ripërtëritshme, 2018-2020*. Marrë nga: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=14893>

²⁵ Për ilustrim, në linkun në vazhdim gjeni të gjithë hapat, lejet dhe pëlqimet që duhet ndjekur për të ndërtuar një njësi të gjenerimit (të vogël) nga BRE: http://ero-ks.org/2017/Autorizimet_Licencat/Aplikacioni%20per%20Autorizim%20-Gjenerator%20te%20VEGJEL.PDF

²⁶ ZRRE (2018). *Regjistri i Aplikacioneve për Ndërtim të kapaciteteve të reja gjeneruese dhe Pranimi në Skemë Mbështetëse nga BRE*. Marrë nga: http://ero-ks.org/2018/Autorizimet_Licencat/12_11%202018%20Regjistri%20i%20Aplikuesve%20p%C3%ABr%20Autorizim%20dhe%20Pranim%20ne%20Skemen%20Mbeshtetese.pdf

²⁷ Për më tepër detaje, lista e të gjitha autorizimeve/licencave të lëshuara nga ZRRE: http://ero-ks.org/2018/Autorizimet_Licencat/15_03_2018_Regjistri_L_Aplikuesve_per_Autorizim.pdf

era apo solare. Kosova ende rregullon tarifat për konsumatorët – dhe si të tilla, vendosja e tyre rregullohet me legjislacion. Për shkak të mosliberalizimit të tregut, konsumatorët nuk marrin çmimin më të mirë të mundshëm por atë të rregulluar nga ZRRE. Në fakt, konsumatorët bartin kostot e tarifës nxitëse përmes një pagese specifike për shërbimet e operatorëve të sistemit.

Tabela 4. Tarifat nxitëse të miratuara nga ZRRE më 19 Maj 2016.^{28 & 29}

Energjia solare	€ 136.4 për MWh
Hidroenergja	€ 67.47 për MWh
Biomasa	€ 71.30 për MWh
Energjia e erës	€ 85 për MWh

Limiti për ti kualifikuar hidrocentralet e reja në skemën mbështetëse është 10 MW. Mundësitë për HC të mëdha janë të kufizuara dhe ato mund të sjellin implikime mjedisore. Skema mbështetëse siguron çmim fiks prej 67.47 Euro për MWh në një periudhë deri 12 vite.³⁰

3.5 Standardet dhe normat evropiane

Kosova është ende në fazën e hershme të implementimit të standardeve ambientale të kërkuara nga Bashkimi Evropian. Kryesisht, institucionet e vendit janë të koncentruara në transpozimin dhe kompletimin e direktivave evropiane në ligjin vendor, forcimin e kornizës institucionale e atë të strategjive dhe të shtimit të buxhetit dedikuar ambientit.³¹

Dy direktiva evropiane ndërlidhen me hidrocentralet në mënyrë indirekte. Direktiva për Burimet e Ripërtërishme të Energjisë – 2009/28/EC, dhe Direktiva 2000/60/EC e Komisionit Evropian për Ujërat, të cilat duhet të specifikohen për hidrocentralet ngase janë në kontradiktë në mes vete.³² Kosova nuk është anëtare në asnjërin nga mekanizmat për mbrojtjen e ambientit siç janë: *Konventa e Bernës*, *Konventa e Aarhusit* apo *Natura 2000*. Ndryshimi i rrjedhës natyrale të ujit është problemi elementar i hidrocentraleve të vogla. Për këtë arsye është me rëndësi të madhe që të ketë një monitorim strikt të rrjedhës minimale të rezervuar në mënyrë që të sigurohet mbrojtja dhe ekzistenca e habitateve ekologjike dhe natyrore.

Raportet e Progresit për Kosovën përmendin në mënyrë eksplicite se të gjitha hidrocentralet duhet të jenë në përputhje me kornizën ligjore mjedisore të BE-së. Madje cilësohet se Kosova ka edhe probleme

²⁸ RES LEGAL Europe (2019) *Kosovo Feed-in Tariff*. Marrë nga <http://www.res-legal.eu/search-by-country/kosovo/single/s/res-e/t/promotion/aid/feed-in-tariff-13/lastp/427/>

²⁹ ZRRE (2016). *Feed-in Tariff Decision No. VI*. Marrë nga http://ero-ks.org/2016/Vendimet/V_810_2016_eng.pdf

³⁰ Ministria e Zhvillimit Ekonomik (2016). *Strategjia e Energjisë 2017-2026*. Marrë nga: https://mzhe-ks.net/repository/docs/Strategjia_e_energjisë_2017-26_.pdf

³¹ European Environment Agency (2015). *Kosovo* country briefing - The European Environment – State and Outlook 2015*. Marrë nga: <https://www.eea.europa.eu/soer-2015/countries/kosovo>

³² European Commission (2010). *Hydropower and Environment*. Marrë nga: https://ec.europa.eu/energy/intelligent/projects/sites/iee-projects/files/projects/documents/sherpa_report_on_environmental_integration.pdf

me kapacitetin e rrjetit të shpërndarjës së energjisë prej nga mund të lidhen BRE-të. Kosova është zotuar që të arrijë nivelin e prodhimit të energjisë nga BRE-të prej 29.47% deri në vitin 2020, ndonëse në raportin e progresit thuhet se edhe targeti i detyrueshëm prej 25% është vështirë të arrihet. Si shkak përmenden kryesisht vonesat burokratike dhe pajisjet me lincenca të ndryshme si mungesë e një mekanizmi efektiv burokratik/administrativ.³³

Në raportin e progresit poashtu përmendet si problem ndërtimi i HC në zona të mbrojtura: Lufta kundër ndërtimeve të paligjshme në zonat e mbrojtura duhet të zbatohet në mënyrë efektive. Planifikimi i investimeve në infrastrukturë, siç janë hidrocentralet, turizmi dhe sektori i industrisë duhet të sigurojë që detyrimet për mbrojtje të natyrës të respektohen. Kjo vlenë sidomos për zonat e mbrojtura dhe zonat me vlerë të lartë natyrore që potencialisht mund të bëhen vende të mbrojtura sipas *Natura 2000*.

4. Problemet e përgjithshme dhe ndikimet konkrete të hidrocentraleve të reja

Promblematik mbetet fakti se 62% (48 nga 77) e hidrocentraleve të vogla ekzistuese dhe të planifikuara gjenden në brendi të zonave me rëndësi të veçantë natyrore, si parqe kombëtare, rezervate strikte të natyrës, zona të veçanta të mbrojtura, dhe zona me veçori të shumta relikte dhe endemike të florës, vegjetacionit, faunës, habitateve natyrore, bimore dhe shtazore, etj. Kjo paraqet rrezik të madh që këto zona të dëmtohen përgjithmonë dhe të degradohen peisazhet natyrore e burimet ujore të vendit.

Në Maj 2018 është marrë edhe vendimi i Ministrisë së Mjedisit dhe Planifimit Hapësinor për të bërë një moratorium të ndërtimit të hidrocentraleve në vend deri në përfundimin e një vlerësimi të ri të ujërave nëntokësorë e sipërfaqësorë. Poashtu do të ndërmerret edhe një rishikim i plotë i lejeve për HC të reja. Kjo është bërë me qëllim që të vlerësohet gjendja e përgjithshme e këtij sektori dhe të mbrohet natyra.³⁴ Kjo iniciativë paraqet një hap pozitiv pasi që një vlerësim i përditësuar i ujërave nëntokësorë do ta zëvendësonte vlerësimin e kryer në vitin 1984, vlerësim ky që është përdorur për të autorizuar ndërtimin e hidrocentraleve deri më sot.

Bazuar në strategjitë dhe planet e Kosovës për hidrocentrale të reja, disa nga HCV të planifikuara janë në zona të mbrojtura strikte. Ndërtimi i këtyre hidrocentraleve pranë hapësirave me rëndësi të veçantë natyrore (Zona 1) është krim ekologjik i dënueshëm³⁵ dhe dëmton qëndrueshmërinë e parqeve nacionale si dhe dëmton seriozisht biodiversitetin e këtyre anëve, posaçërisht ndikon negativisht në

³³ European Commission (2016). *Raporti i vitit 2016 për Kosovën*. Marrë nga: https://eeas.europa.eu/sites/eeas/files/20161109_kosovo_report_2016_alb.pdf

³⁴ Ekonomia (2018). *Ministrja Reshitaj premtan të nderprejë të gjitha lejet e reja për hidrocentrale*. Marrë nga: <http://www.ekonomia-ks.com/sq/energjetike/ministrja-reshitaj-premtan-te-nderpreje-te-gjitha-lejet-e-reja-per-hidrocentrale>

³⁵ Gazeta Zyrtare (2019). *Kodi Penal i Republikës së Kosovës*. Marrë nga <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2834>

faunë dhe potencialisht në turizmin e atij vendi. Zonimi është proces i cili përcakton vlerën ekologjike të zonës, Zona e 1-rë dhe Zona e 2-të nuk e lejojnë të bëhet ndërtimi i hidrocentraleve.³⁶

Problematikë e madhe e këtyre ndërtimeve të hidrocentraleve është se mungon transparenca, standardet mjedisore, dhe ekziston mundësia të manipulohet me leje të ndryshme. Ndryshimi i destinimit të hartës zonale, nga Zonë 1, apo Zonë 2, në Zonë 3, bëhen me qëllim të përfitimit nga këto kapacitete dhe tarifatat nxitëse. Poashtu mungojnë debatet publike, dhe kërkesat e brengat e banorëve, apo edhe të autoriteteve të nivelit lokal nuk është se mirren parasysh, në anën tjetër ata as nuk kanë edhe ku të ankohen dhe si pasojë lindin edhe konflikte sociale.

Balkan Green Foundation konsideron se hidrocentralet kanë kryesisht këto probleme dhe ndikime negative:

Sociale sepse rrjedhimisht mund të shkaktojnë:

Konflikte shoqërore / Protesta – Kundërshtitë e banorëve, për shkak të shpronësimit, humbjes së qasjes në ujë, dobësisht potencial të turizmit etj. Një pjesë e madhe e popullatës rurale shfrytëzojnë ujin nëntokësor për pije, por edhe për ujitje.

Gjatë muajit Shkurt 2019, Komiteti Ndërministror për Investimet Strategjike tha se propozimet e paraqitura nga Kelkos Energy plotësuan kriteret teknike për t'u konsideruar si projekte strategjike të investimeve. Ky vendim rezultoi në një shpërthim reagimesh nga qeverisja lokale dhe aktivistët mjedisorë që qëndruan së bashku kundër ndërtimit të hidrocentraleve në Lumbardh të Pejës. Për këtë çështje ka pasur protesta në qytetin e Pejës, ku qindra qytetarë u mblodhën për të kundërshtuar ndërtimin e hidrocentralit në këtë pjesë. Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, ka bërë të ditur se ka kërkuar ndërprerjen e menjëhershme të procedurave për ndërtimin e hidrocentraleve në Lumbardh të Pejës.

Politike sepse mund të ndikojnë në:

Konflikt interesi / Shtrembërimin e vullnetit politik – Lidhja ndërmjet bizneseve dhe politikanëve, veçanërisht në marrjen e licencave dhe autorizimeve për ndërtimin dhe operimin e këtyre HC-ve. Ka raste kur grupe të caktuara të interesit bëjnë presion mbi nivelin lokal e qendror për të lejuar investime në HC në zonat e mbrojtura apo edhe në vende tjera. Ka raste kur komuniteti lokal shpërfillet dhe i shtrembërohet vullneti nga individë të papërgjegjshëm apo grupe të interesit.³⁷

³⁶ Kjo ndarje është bërë duke u respektuar Ligjet për Parqet Kombëtare “Bjeshkët e Nemuna” dhe “Sharri” të cilat kërkojnë që hapësirat e parkut t'i kenë 4 zona të cilat dallojnë përnga regjimi i mbrojtjes së tyre. Ato janë: 1. Zona e parë – mbrojtja strikte; 2. Zona e dytë – menaxhimi aktiv; 3. Zona e tretë – shfytëzimi i qëndrueshëm; 4. Zona e ndikimit – jashtë parkut, 50 metra nga kufiri i parkut.

³⁷ Insajderi (2016). *Hidrocentrali i Vëllait të Shaip Mujës merr Mbështetjen e Kaçanikut të PDK-së*. Marrë nga <https://insajderi.com/hulumtime/hidrocentrali-vellait-te-shaip-mujes-merr-mbeshtetjen-e-kacanikut-te-pdk-se/>

“Në përpjekje për të përmbushur objektivat e Bashkimit Evropian për prodhim të energjisë alternative, autoritetet kosovare janë mobilizuar në lëshimin e licencave për ndërtim hidrocentralesh. Një prej përfituesve është edhe vëllai i Shaip Mujës, ë ishç deputetit të PDK-së. Kompania “Afa Energy”, ku është hisedar Fatmir Muja, po përballlet me kundërshtimet e banorëve dhe organizatave jo-qeveritare në Kaçanik, që e vlerësojnë si të dëmshëm ndërtimin e hidrocentralit në pellgun e lumit Lepenc.”

Subvencionim të hidrocentraleve – Taksimi i gjithë popullatës që paguan energjinë elektrike nëpërmjet feed-in tarifave për këto projekte që mund të dëmtojnë ambientin dhe turizmin dhe nga të cilat përfitojnë disa kompani private.

“Sipas ligjit, hidrocentralet e ndërtuara nga Kelkos Energy ende nuk e kanë lejen për prodhimin e rrymës ngase nuk e kanë përfunduar studimin mbi ndikimin në mjedis, por siç ëshihetç, kjo nuk e ndal Kelkosin. Ata jo vetëm që prodhojnë rrymë pa leje, por e bëjnë këtë në mënyrën më degraduese të mundshme.”

Ekonomike ngase ndikon në:

Ujitje dhe në ujin e pijes – Mund të dëmtohet ujitja për nevojat bujqësore për shkak të diverzionit të rrjedhës së ujit. Ndërtimi i HC-ve mund të shkaktoj kontaminimin e ujit të pijës me materiale ndotëse si dhe në zvogëlim të nivelit të ujërave nëntokësorë.

Në turizëm – Për shkak të ndryshimit të peisazhit dhe ndryshimit të rrjedhës natyrore të lumenjëve mund të ndikohet edhe turizmi gastronomik, rural, aktivitetet rekreative ujore, turizmi malor/hiking etj.

Balancin energjetik – Rryma e prodhuar ndryshon verë/dimër, që ka implikime të mëdha dhe i bënë këto HC të mos ofrojnë rrymë të vazhdueshme e të qëndrueshme elektrike.

Degradim të tokave bujqësore – Erozion, mungesa e ujit për ujitje, shpronësim, ulje e nivelit të ujërave nëntokësorë e sipërfaqësorë.

Mjedisore sepse mund të ndikojnë në:³⁸

Shkatërrimin dhe modifikimin e habitateve natyrore – Punimet për ndërtimin e këtyre objekteve kanë impakte negative në mjediset natyrore të shumë gjallesave, të cilat dëmtohen si gjatë ndërtimit po ashtu edhe gjatë operimit/mirëmbajtjes dhe të cilat pësojnë ndryshim të madh dhe shpesh të pariparueshëm (shembull – vajrat motorike ose vajrat për ftohje të rotorit të turbinës së hidrocentralit).

“Kelkos Energy ka shkelur kontratën me Kosovën pikërisht gjatë ndërtimit të hidrocentraleve, pasi që nuk i ka mbrojtur burimet e vogla që ishin përgjatë lumit, gjë që ishte e obliguar me ligj. Gjatë bisedave me zyrtarë të komunës së Deçanit rreth kësaj çështjeje, ata jozyrtarisht konfirmuan këtë, mirëpo kontrata nuk është bërë publike asnjëherë.”

³⁸ Prishtina Insight (2018) *An open letter to Haradinaj on the degradation of nature in the Decan canyon*. Marrë nga: <https://prishtinainsight.com/an-open-letter-to-haradinaj-on-the-degradation-of-nature-in-the-decan-canyon/>

Erozionin e tokës – Për shkak të ndërtimeve, instalimeve të tubacioneve, ndërtimit të hidrocentraleve dhe hapjes së rrugëve të reja.

“Kelkos Energy me pretekst se po ndërton pendë ujitëse në Zallë të Rupës, çrrënjosi karakteristikat e rralla të lumit të egër që ishte një ndër të fundit të këtij lloji në Ballkan. Pasi që lumi shtrihej mbi një tokë zallore, Kelkosi plaçkiti tonelata zallë dhe la pas vete vetëm gropa të mbushura me ujë që rrezikojnë jetën e kalimtarëve dhe bjeshkatarëve që jetojnë e punojnë aty. Kur zalli i hapësirës së grupuar nuk iu desh më, Kelkosi ka dalë me konstatimin se Zalli i Rupës nuk qenka terren i përshtatshëm për ndërtimin e pendës ujitëse, gjë që është dashur të dihet që në fazën propozuese.”

Dëmtimin e pyjeve dhe natyrës – Edhe kjo ndodhë zakonisht direkt gjatë fazës së ndërtimit por mund të ndodhë edhe gjatë operimit/mirëmbajtjes, ku biodiversiteti i asaj zone preket dhe ndikohet nga prezenca e njerëzve në habitatin i tyre natyror.

“Si kusht për leje të ndërtimit, Kelkos Energy duhej të ndërtonte në Deçan një park prej 1 milion euro. Parku, që është ndërtuar është më shumë një sipërfaqe e mbuluar me gurë dhe cement dhe nuk duket të jenë ishin shpenzuar as 1% e buxhetit të premtuar.”

Tharjen e lumenjëve – Kjo ndodhë për shkak të ridrejtitimit të rrjedhës së ujit në tubacionet e hidrocentraleve, për pasojë pjesë të tëra të lumenjëve mund të thahen tërësisht, dhe një pjesë e këtyre rrjedhave të kaloj plotësisht nën sipërfaqe të tokës e që ka ndikim katastrofik në biodiversitet. Gjithashtu ndikon direkt në gërryerjen natyrore të atyre anëve, sidomos nga shirat e rrëmbyeshëm dhe erërat.

Ligji kërkon që gjithmonë minimumi prej 30% e ujit duhet të qëndrojë në shtrat të lumit. ëSipas raportimeve nga banorëtç Kelkos Energy e lë shtratin e lumit të zbrazur duke futur 100% të ujit në gypa, gjë që rezulton në vdekjen e biodiversitetit dhe shterjen e lumit.

Ndotjen e ujit për shkak të punimeve – Për shkak të punimeve mund të ndoten ujërat sipërfaqësorë, e ata nëntokësorë me vajra motorike apo me turbullim, duke ndikuar direkt negativisht gjallesat në këto habitate.

Ndotjen e mjedisit gjatë mirëmbajtjes – Pengon jetën e faunës gjatë mirëmbajtjeve të punës ditore të HC-ve (ardhja e vajtja e punëtorëve).

4.1 Rast Studimi: Parku Kombëtar “Bjeshkët e Nemuna” – Kaskada e Lumbardhit

Bjeshkët e Nemuna janë park kombëtar zyrtarisht që nga viti 2012 dhe zonë e veçantë e mbrojtur me ligj. Përkundër kësaj, institucionet e qeverisë së Kosovës planifikojnë të ndërtojnë një mori të madhe të HCV-ve, gjithsej 21 të reja vetëm brenda parkut kombëtar të Bjeshkëve të Nemuna. Aktualisht në këtë park gjenden hidrocentrali i Belajës, i Deçanit, Belaja, dhe Lumbardhi 1 & 2 me total 31 MW të instaluar.

Pjesa më e madhe e hidrocentraleve të planifikuara që të ndërtohen do të jenë pikërisht në këto zona ose fare afër tyre, gjë që do të shkaktoj probleme dhe interferime të shumta, sidomos për faunën. Situata do të përkeqësohet veçanërisht në Lumbardhin e Pejës ku janë të planifikuara një mori hidrocentralesh e që kryesisht janë në Zonën 1 të mbrojtur të parkut. Situata është e keqe edhe në Lumbardhin e Deçanit, ku atje veçse operojnë disa hidrocentrale dhe shtimi i numrit të tyre do ta rëndojë situatën edhe më tej.

Investimet e fundit që kanë ndodhur në luginën e Lumbardhit të Deçanit nga kompania austriake Kelkos Energy kanë rezultuar me probleme të shumta mjedisore, me projekte gjysmake dhe të dështuara që i kanë vënë hije të keqe investimeve në sektorin e hidroenergjisë. Ky rast ka shtyrë Komunën e Deçanit të ndërmerrë edhe hapa ligjor me kërcënim për të ngritur padi ndaj kompanisë në fjalë si dhe ndaj vetë MMPH-së për mos-respektim të minimumit biologjik.³⁹

Ndër hapësirat dhe bjeshkët më të bukura në Kosovë janë në rrezik të shkatërrimit të pakthyeshem nga ndërhyrja brutale me qëllim të prodhimit të energjisë elektrike nga uji, në kuadër të shtimit të nivelit të energjisë së ripërtëritshme. "Banorë të qytetit të Deçanit janë alarmuar nga rritja shumë e shpejtë e projekteve zhvillimore që rrezikojnë lumenjtë dhe bjeshkët nga degradimi ambiental por dhe që kanë efekt direkt në jetën e popullatës atje."⁴⁰

Kështu, Komuna e Deçanit por edhe ajo e Pejës, kanë marrë qëndrim që të ndalojnë kategorikisht ndërtimet e reja të hidrocentraleve në Lumbardhin e Deçanit e atë të Pejës, ku këto projekte shihen si degradim i natyrës dhe që pengojnë dukshëm zhvillimin e turizmit dhe biejnë ndesh me planet dhe projektet komunale të zhvillimit e kanë ndikim negativ në turizëm.⁴¹ Prej këtyre projekteve po përfitojnë kryesisht grupe të caktuara të interesit e jo Deçanasit apo qytetarët e Pejës dhe prandaj kanë vendosur që të mos lëshojnë leje ndërtimi për HCV apo të mëdha në ato hapësira, pavarësisht se institucionet tjera të nivelit qendror u kanë dhënë leje.

Kështu, pavarësisht të gjitha shqetësimeve nacionale dhe debatit të gjërë shoqëror kundër ndërtimeve të hidrocentraleve nëpër zona të veçanta dhe vendosjes së moratoriumit të përkohshëm për ndërtimin e hidrocentraleve të reja nga MMPH deri në krijimin e një studimi të ri të gjendjës së ujërave në Kosovë, Komisioni Ndërmintor për Investime Strategjike i ka dhënë dritën e gjelbërt vazhdimin e këtyre projekteve.⁴² Rrjedhimisht, investitori Kelkos Energy i cili është po i njejtë investitor në Grykën e Deçanit, në vend se të parandalohet për shkeljet e shumta të bëra aty por edhe për shkak të humbjes së licencës, shpërblehet me vazhdimin e një projekti 97 milionësh i cili do të bëjë dëme të pariparueshme grykës së Lumbardhit të Pejës.

³⁹ Komuna e Deçanit (2018), *Komunikatë për mediat e shkruara dhe elektronike*. Marrë nga: <https://kk.rks-gov.net/decan/news/komunikate-per-mendiat-e-shkruara-dhe-elektronike/>

⁴⁰ Kallxo.com (2018), *Vuajtja e Grykës së Deçanit nga hidrocentralet*. Marrë nga: <https://kallxo.com/vuajtja-e-grykes-se-decanit-nga-hidrocentralet-foto>

⁴¹ Gazetaexpress (2016) *Kryetari i Pejës, kundër ndërtimit të hidrocentraleve në Rugovë*. Marrë nga: <https://www.gazetaexpress.com/lajme/kryetari-i-pejes-kunder-ndertimit-te-hidrocentraleve-ne-rugove-265288/?archive=1>


⁴² Ministria e Tregtisë dhe Industrisë (2019), *Edhe dy investitorë përbushin kriteret teknike, planifikojnë investimin e 225 milionë eurove*. Marrë nga: <https://mti.rks-gov.net/Page.aspx?id=1.%203.758>

Ky projekt që parasheh ndërtimin e rreth 5 hidrocentraleve të vogla, dhe një hidrocentrali të madh me rreth 40 MW⁴³ dhe me një shtrirje të tubacioneve prej 25 KM do të ketë pasoja të mëdha në zhvillimin e qëndrueshëm të Grykës së Rugovës dhe Pejës, do të ndikojë negativisht në turizëm, do të bëjë dëmtime ekologjike të pariparueshme, prandaj edhe aktivisht po kundërshtohet nga komuniteti i Rugovës dhe ai i Pejës.⁴⁴ Kështu, Kryeministri i Kosovës Ramush Haradinaj është deklaruar hapur që ky projekt do të ndërpritet dhe rishikohet dhe se nuk do të lejohet të vepohet kundër interesave legjitime të rugovasve, krejt kjo pas protestave të organizuara e të tjerave të thirrura.

⁴³ ZRRE (2016). *V_796_2016*. Marrë nga: http://ero-ks.org/2016/Vendimet/V_796_2016.pdf

⁴⁴ Green Kosovo (2019). *Peja Municipality Mayor is Against the Building of Hydropower Plants in the Stream of Lumbardhi*. Marrë nga: <http://greenkosovo.com/peja-municipality-mayor-is-against-the-building-of-hydropower-plants-in-the-stream-of-lumbardhi>

Figura 3. Parku Kombëtar Bjeshkët e Nemuna: Zonimi sipas MMPH-së (në të majtë) dhe hidrocentralet ekzistuese dhe ato në planifikim (në të djathtë).



Burimi: MMPH (2015) & Riverwatch (2018)

Siç mund të shihet nga krahasimi i këtyre dy hartave në Figurën 3, këto hidrocentrale bien në zona të rëndësishme e të ndjeshme të biodiversitetit. Këto janë Zonta të Veçanta të mbrojtura me ligj, ku nuk lejohet ndërhyrja dhe modifikimi i asaj hapësire.⁴⁵ Shqetësues është fakti që në raste të caktuara formohet këshill ndër-ministror që ka fuqinë ekzekutive që të ndërroj zona të caktuara prej **Zonës së Parë në Zonë të Tretë**. Në Zonën 3 lejohet ndërtimi i hidrocentraleve. Në Zonën 1 dhe 2 kjo nuk është e mundur. Një mundësi e tillë është e padrejtë dhe duhet të rregullohet në mënyrë ligjore. Kompetencë e tillë e përcaktimit të zonave dhe hartave zonale e zonimit duhet t'i takoj ekskluzivisht ekspertëve dhe të mos ketë politizim e ndikime politike në të e aq më tepër nuk duhet asesi të ndërtohen në parqe kombëtare.

Shqetësues mbet edhe planifikimi i intervenimit në hapësirën e Junikut ku janë paraparë të ndërtohen disa hidrocentrale, e ku e tërë ajo hapësirë ka bukuri të rrallë natyrore dhe vlera të mëdha të biodiversitetit.

4.2 Rast Studimi: Parku Kombëtar “Sharri” – Kaskada e Lepencit

Parku Kombëtar i bjeshkëve të Sharrit është park kombëtar që nga viti 1986. Kjo hapësirë përfshinë edhe numrin më të madh të hidrocentraleve të parapara që të ndërtohen në të dhe që janë ndërtuar viteve të fundit me një dinamikë të shtuar të punimeve, me plot 32 vepra të parapara (Burimi: Riverwatch). Prej lumenjëve më të fuqishëm në aspektin hidrik në të cilët ishte paraparë të shfrytëzohej për ekonominë e Kosovës ishte Lepenci në sistemin hidrik Ibër–Lepenci, porse kurrë nuk kishte përfunduar. Ky ishte projekt që kishte për qëllim ujitjen e tokës dhe shfrytëzimin e ujit për qëllime industriale. Pikërisht në këtë lum janë duke u ndërtuar disa hidrocentrale dhe ai më i rëndësishmi është hidrocentrali Lumbardhi 3 me fuqi rreth 10 MW. Shumica e aplikacioneve në ZRRE për hidrocentrale të reja, që gjinden në listen e autorizimeve finale gjenden pikërisht në këtë park dhe në pellgun e lumit Lepenc.

Ngjashëm sikurse në parkun kombëtar të Bjeshkëve të Nemura janë evidentuar probleme edhe në pellgun e këtij lumi ku janë planifikuar të ndërtohen shumë hidrocentrale. Organizata “Gjethi” në studimin e tyre *“Arsyeshmëria e ndërtimit të hidrocentraleve të reja në pellgun e lumit Lepenc, dhe pse nuk duhet vazhduar me ndërtimin e tyre”*, jep argumente të fuqishme të shkatërrimit mjedisor dhe përmend degradimin mjedisor, përfitimet ekonomike të njëanshme të operatorëve të ndryshëm dhe përmend humbjet sociale, ekonomike nga këto ndërtime, humbje këto që ndërlidhen me ndryshimin e rrjedhës së lumenjëve duke i futur e zhdukur ato nëpër tuba dhe duke bërë dëmtimin e ekosistemit në tërësi.

Aty ndër të tjera përmenden edhe probleme me furnizim të ujit për vetë banorët e komunave të Hanit të Elezit si dhe në atë të Kaçanikut, që veçse kanë probleme me furnizim me ujë. Efekte negative rrjedhin edhe nga moszbatimi i kornizës ligjore e standardeve gjatë fazës së ndërtimit e funksionalizimit të

⁴⁵ Gazeta Zyrtare (2008). *LIGJI NR. 03/L-039 PËR ZONAT E VEÇANTA TË MBROJTURA*. Marrë nga: <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2529>

këtyre impianteve që kanë efekt direkt edhe në cilësinë e ujit. Vlenë të përmendet edhe shpërdorimi i vullnetit të qytetarëve nëpërmjet përfaqësuesve të rrejtshëm dhe fuqisë së grupeve të interesit.⁴⁶

Në Brezovicë dhe në shumë vende të tjera janë tharë lumenjtë për shkak të ndryshimit të rrjedhës së ujit nga HCV. Probleme të raportuara ka sidomos në anën e Bjeshkëve të Sharrit në anën e Dragashit dhe në zonën e Gorës ku ka pasur shterje dhe devijim të lumenjëve e si rrjedhojë edhe konflikte e rezistencë qytetare nga banorët lokal të cilët gati kudo kanë kundërshtuar ndërtimin e hidrocentraleve. Komuna e Prizrenit, për shkak të problemeve të shumta jo vetëm mjedisore por edhe sociale ka ndaluar ndërtimin e hidrocentraleve.⁴⁷

5. Përfundim

Energjia nga burimet e ripërtrishme është e ardhmja e sistemit energjetik të Kosovës. Si e tillë, shfrytëzimi i duhur i saj është crucial për të siguruar se tranzicioni energjetik është në funksion të mbrojtjes së mjedisit dhe rritjes së kualitetit të jetës së qytetarëve. Lejimi i zhvillimit të një morie kaq të madhe të hidrocentraleve në zonat e mbrojtura dhe rrjete ekologjike është i papranueshëm: planifikimi si i tillë nuk është real dhe mbartë pasoja afatgjate e ndërlikime mjedisore të panevojshme. Kosova është e pakët me ujë, shumë më pak se të gjithë fqinjët e saj, dhe gjithashtu ka në mesin e tyre nivelin më të ulët të zhvillimit dhe ruajtjes së burimeve ujore. Atë pak ujë që ka mbetur dhe që nevojitet për pije, ujitje dhe industri, Kosova nuk duhet ta shfrytëzojë për prodhimin e një sasie simbolike të energjisë elektrike që ka diku vetëm rreth 33% kapacitetin operues në krahasim me fuqinë e instaluar.

Në aspektin ekonomik, këto hidrocentrale nuk do të ishin shumë profitabile dhe as që do të kishin mundësi që të përbëjnë një bazë të rëndësishme të prodhimit të energjisë elektrike – kjo e ndërlidhur direkt me lejën e pëlqimit ujor që është valid në kohën prej muajit tetor deri në maj, pra në kohën kur ka të rreshura, një fenomen ky që është duke u ndikuar edhe nga ngrohja globale dhe ndryshimet klimatike. Kjo ndër të tjera i bën këto hidrocentrale jo-konkurruese në krahasim me burimet tjera alternative të energjisë.

Po ashtu është e rëndësishme që Kosova të jetë konform normave e standardeve evropiane dhe si rrjedhojë t'i respektojë ato zona të mbrojtura që në të ardhmën mund të hyjnë në zona të rregulluara nga direktivat evropiane ku ndalohet ndërtimi i hidrocentraleve siç janë zonat me potencial për të qenë në listën e *Natura 2000*. Një problem i rëndësishëm dhe shqetësim serioz ka të bëjë me zonat strikte të cilat me vendime politike edhe ndryshohen nga Zona 1, 2 në Zonë 3, për të mundësuar ndërtimin e këtyre hidrocentraleve.

⁴⁶ OMM "Gjethi" (2017). *Arsyeshmëria e ndërtimit të hidrocentraleve të vogla në Pellgun e Lumit Lepenc dhe pse nuk duhet vazhduar me ndërtimin e tyre*. Marrë nga https://www.linkedin.com/pulse/arsyeshm%25C3%25ABria-e-nd%25C3%25ABrtimit-t%25C3%25AB-hidrocentraleve-vogla-n%25C3%25AB-pellgun-stagova/?fbclid=IwAR2wgcXbc7o2tcwtPl_xLeq6Mo46Mv5TOiHe70fZzqu4ZV_0vdHX8d_Ycmc

⁴⁷ KOHA (2018). *Moratorium për ndërtimin e hidrocentraleve të vogla në Luginë të Lumbarshit të Prizrenit*. Marrë nga: <https://www.koha.net/kosove/119198/moratorium-per-ndertimin-e-hidrocentraleve-te-vogla-ne-lugine-te-lumbarshit-te-prizrenit>

Kosova nuk ka bazë reale që t'i akomodojë një numër të tillë të propozuar të hidrocentrale të reja, të cilat do të ndërtoheshin në pjesën më të madhe në parqet kombëtare të Sharrit dhe Bjeshkëve të Nemuna (48 prej tyre të planifikuara) së cilave do t'i dëmtohej biodiversiteti dhe do t'iu ulej vlera turistike dhe ajo e përgjithshme. Nuk ka aktivitete ekonomik pa ndikim në mjedis dhe vendosja e tërë këtyre hidrocentraleve (pjesa më e madhe e projekteve të reja) do të përbënte një krim ekologjik dhe shëmtim të vlerave tona natyrore. Parqet kombëtare duhet të qëndrojnë të paprekura dhe të pastra nga këto ndërhyrje, ngase ato paraqesin një trashëgimi monumentale natyrore për breza të tërë, vende relaksi e inspirimi dhe askush nuk ka të drejtë t'ua mohoj këtë gjë.

Ndërtimi i kapaciteteve të reja energjetike nuk është bërë me një planifikim që do të merrte parasysh kapacitetet, ndikimin në mjedis dhe nevojat dhe qëndrimet e institucioneve lokale dhe akterëve të tjerë shoqëror. Ky çalim i theksuar në planifikim shfaqet edhe në hartimin e strategjive të energjisë ku potencialet e teknologjive të ndryshme bëhet pa studime serioze dhe ku futen projekte si ai i Hidrocentralit të Zhurit që nuk ka perspektivë reale për t'u zhvilluar. Në të njëjtën kohë, planifikimit i mungon diskutimi i zgjeruar në lidhje me projekte të veçanta në të cilat diskutime qytetarët do të mund të shprehnin kërkesat e tyre.

Mungojnë mekanizmat efektiv të monitorimit të zbatimit të projekteve. Zyra e Rregullatorit për Energji, Inspektorati i Mjedisit dhe mekanizmat e tjerë kanë dështuar të sigurojnë se projektet respektojnë standardet mjedisore dhe obligimet ligjore që kanë. Në mungesë të mekanizmave mbikëqyrës, kompanitë në shumë raste kanë abuzuar me licencat dhe nuk kanë respektuar kushtet e kontratave. Kjo mungesë e inspektimeve dhe ndëshkimeve ka rezultuar me zona të dëmtuara dhe aktivitete të paligjshme e rrjedhimisht kjo është shoqëruar edhe me probleme sociale.

Ka një mungesë të theksuar të koordinimit ndër-institucional edhe sa i takon përcaktimit të prioriteteve por edhe në mbikëqyrjen e zbatimit të projekteve. Kjo mungesë e koordinimit shprehet edhe me qëndrime me raste edhe konfrontuese në mes të Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Zyrës së Rregullatorit për Energji, komunave etj. Mungesa e koordinimit ndër-institucional ka krijuar një amulli në funksionimin e institucioneve dhe një gjendje të vakumit në zbatimin e një politike unike shtetërore.

6. Rekomandime

1. Politikëbërja duhet të ketë në fokus mjedisin në hartimin e strategjive dhe të rivlerësohet potenciali i burimeve të ripërtëritshme për prodhimin e energjisë elektrike në Kosovë. Rrjedhimisht, të rishikohen caqet indikative nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik dhe burimet prej HCV. Si rezultat, projektet e ndërtimit të kapaciteteve të reja nga uji duhet rreptësisht të ndalohen në parqe kombëtare dhe zona të mbrojtura të natyrës. Krijimi i këtyre politikave duhet të bëhet me transparencë të plotë duke përfshirë qytetarët, komunitetin dhe shoqërinë civile.

2. Mekanizmat ligjor, veçanërisht masat juridike që mundësojnë ndryshimin e destinimit të hapësirave të zonave të mbrojtura në parqe kombëtare duhet të ndalohen. Të ndalohet ndryshimi i destinimit nga Zonë 1 ose Zonë 2, në Zonë 3, vetëm nëse ekspertët relevant e përcaktojnë, kurse institucionet e zbatojnë.

3. ZRRE si rregullatori kryesor i energjisë në vend duhet të jap leje vetëm atëherë kur plotësohen kriteret dhe standardet ambientale dhe të lejohen të bëhen ndërtime të gjeneratorëve të rinjë vetëm në ato vende ku janë të përshtatshme për hidrocentrale. Rrjedhimisht, të bëhet një studim i pavarur nga agjencionet e specializuara që do të mund të identifikonin vendet e përshtatshme për HCV dhe ato të i'u nënshtrohen një vlerësimi profesional të ndikimit në mjedis para se të jipen licenca ose autorizimi. Rregullat dhe licencimi për projektet e reja duhet të jenë në pajtueshmëri me ambientin dhe në harmoni me kërkesat dhe nevojat e komunitetit.

4. Rrjedha e rezervuar e lumenjëve të monitorohet në mënyrë strikte nga institucionet kompetente sidomos gjatë stinës së verës e të respektohet në plotësi pëlqimi ujqor dhe minimumi biologjik prej 30% sikurse është e përcaktuar me udhëzim administrativ.

5. Duhet të bëhet përdorimi i skemave të shumëfishta si metodë për impakt minimal ambiental dhe shfrytëzim eficient të burimeve hidrike. Kjo mund të ndodhë nëpërmjet shfrytëzimit maksimal të kanaleve ujtitëse për gjenerim të elektricitetit, apo adoptimin e mullinjëve të vjetër për prodhim të energjisë në sisteme apo liqene ekzistuese për ujë të pijes më rënje të madhe, etj.

6. Nevojitet më tepër monitorim nga ana e MMPH-së për punët e investimeve në hidroenergji. Digjitalizimi i sistemit të monitorimit, publikimi i rezultateve të këtyre monitorimeve do të ndikonte pozitivisht në transparencën e këtyre projekteve dhe në performancën e tyre më të mirë në raport me ambientin. Shumica e operatorëve i'u përmbahen detyrimeve ligjore, ndonëse Balkan Green Foundation konsideron se ka hapësirë për përmirësim në monitorimin e punës së hidrocentraleve ekzistuese që operojnë në vend.

7. Të vazhdohet moratoriumi i vënë nga MMPH për ndalimin e ndërtimit të hidrocentraleve të reja deri në publikimin e një analize të detajuar e shkencore mbi gjendjen dhe potencialin real të ujërave në

Kosovë dhe kjo të jetë bazë e masterplan që rregullon edhe ndërtimin e hidrocentraleve të reja apo atyre në planifikim/ndërtim/operim.

8. Hidrocentralet të mos përdoren për qëllime të thjeshta afariste, të merren parasysh standardet mjedisore e evropiane në implementim rreth ndërtimit të hidrocentraleve ngase ato mungojnë. Mjedi është më i rëndësishëm për zhvillimin e qëndrueshëm të Kosovës sesa degradimi i natyrës me pak MWh që nuk kanë ndikim në plotësimin e kërkesës së madhe të vendit për energji.

9. Të orientohen politikat shtetërore zhvillimore të BRE-ve nga ato me impakt më të vogël mjedisor e më të madh ekonomik që krijojnë më shumë vende pune e kanë efekt pozitiv në ekonomi. Të tilla projekte energjetike me potencial shumë më të madh në Kosovë duhet të vijnë nga burimet e erës dhe ato solare të cilat janë një potencial thuajse i pashfrytëzuar i Kosovës. Balkan Green Foundation mirëpret propozimet e fundit të MZHE-së për alokimin e kapaciteteve në skemën mbështetëse nga hidroenergja në energji me erë.

10. Në mënyrë që hidrocentralet të jenë të qëndrueshme dhe të mos krijohen konflikte me komunitetet lokale duhet të ketë involvim të plotë të akterëve relevant në këto projekte që shfrytëzojnë ujin si dhe të identifikohen mënyrat më kost-efektive të shfrytëzimit të resurseve ujore. Gjetja e zgjidhjeve më të përshtatshme nëpërmjet komunikimit efektiv të të gjitha palëve të përfshira mundëson mirëkuptimin mes palëve.

11. Nevojitet koordinim më i madh ndër-institucional. Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Zyra e Rregullatorit për Energji, komunat, inspektorati dhe mekanizmat e tjerë institucional duhet të koordinojnë politikat e tyre në mënyrë që të maksimizohen efektet pozitive në investime. Koordinimi ndër-institucional është i domosdoshëm për të siguruar se hartimi i politikave dhe zbatimi i tyre është në harmoni me përkushtimet e Kosovës në fushën e energjisë së ripërtrishme dhe mbrojtjes së mjedisit dhe zbatimi i tyre merr parasysh nevojat socio-ekonomike të popullatës.

7. Aneks

7.1 Hidrocentralet në vend

Tabela 1. Hidrocentralet në Kosovë, të kyçura në rrjetin e transmisionit. Burimi: KOSST, 2018

HC	Gjeneratori	Viti i lëshimit në punë	Fuqia e dukshme (MVA)	Fuqia e instaluar (MW)	Neto (MW)
HC Ujmani	G1	1981	19.5	17.5	16
	G2	1981	19.5	17.5	16
Gjithsej Ujmani			39	35	32
HC Lumbardhi 1	G1	1957/2005	5.05	4.04	4.00
	G2	1957/2005	5.05	4.04	4.00
HC Lumbardhi 2	G1		6.38	5.4	5.20
EGU Belaja	G1	2015	5.88	5.29	5.00
	G2	2015	3.11	2.79	2.50
EGU Decani	G1	2015	11.24	6.66	6.50
	G2	2015	5.47	3.15	3.00
HC - Kaskada e Lumbardhit			42.18	31.37	30.20
Gjithsej HC të kyçura në transmision			81.18	66.37	62.20

Tabela 2. Kosova ka këto hidrocentrale të lidhura direkt në rrjetin e distribucionit. Burimi: KOSST, 2018

HC	Gjeneratori	Viti i lëshimit në punë	Fuqia e dukshme (MVA)	Fuqia aktive (MW)
HC Radavci	G1	1934/rindërtimi 2010	0.5	0.45
	G2	1934/rindërtimi 2010	0.5	0.45
Gjithsej HC Radavci			1	0.9
HC Burimi	G1	1948/rindërtim 2011	0.475	0.427
	G2	1948/rindërtim 2011	0.475	0.427
Gjithsej HC Burimi			0.95	0.854
HC Dikanci	G1	1957/riparim faza 1-2010	0.55	0.5
	G2	1957/riparim faza 1-2010	0.55	0.5
	G3	Shkurt 2013/ i ri	2.921	2.34
Gjithsej HC Dikanci			4.021	3.34
HC Brodi 2	G1	Tipi i turbinës Fransis, 2015		2.8
	G2	Tipi i turbinës Pelton, 2015		2.2
Gjithsej HC Brodi 2			0	5
HC Restelica 1 & 2	G1	Tipi i turbinës Pelton, 2015		1.2
	G2	Tipi i turbinës Pelton, 2015		1.2
Gjithsej HC Restelica 1 & 2			0	2.4
HC Hydroline-Albaniku 3	G1	Hitzinger, fundi i vitit 2015	3.6	3.147

	G2	Hitzinger, 2016	1.4	1.068
Gjithsej HC Hydroline-Albaniku 3			5	4.215
Hidroenergji (Lepenci 3)				4.4
				4.3
				1.3
Matkos grup (HC Brezovica)				2.1
EKO Energji (HC Binqa)				0.6
Gjithsej HC të kyçura në Distribucion				29.409

7.2 Institucionet dhe akterët që ndërlidhen për pajisje me leje për HC të ri

1. Agjencioni për Regjistrimin e Biznesit në Kosovë
 - Regjistrimi i biznesit
2. Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
 - Leja mjedisore
 - Leja për shfrytëzimin e ujit
 - Leja për ndërtim (për kapacitete të instaluar me fuqi mbi 10 MW)
3. Leje nga:
 - Agjencia e Pyjeve të Kosovës – nëse ndërtimi bëhet në pyll
 - Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit – nëse ndërtimi bëhet në zonë me interes të veçantë
4. Ministria e Infrastrukturës
 - Leja për kyçje në infrastrukturën ekzistuese rrugore
5. Komuna
 - Leja për ndërtim (për kapacitete të instaluar me fuqi nën 10 MW)
 - Kontrata për shfrytëzimin e tokës
6. KEDS dhe KesCo
 - Autorizim për kyçje në sistemin e shpërndarjes së energjisë
 - Kontrata për blerjen e energjisë nga furnizuesi
7. Zyra e Rregullatorit të Energjisë
 - Licencim për gjenerim të energjisë (për kapacitete të instaluar me fuqi mbi 5 MW)
 - Autorizim për gjenerim të energjisë (për kapacitete të instaluar me fuqi nën 5 MW)